

**INTERVISTA E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-së, AMBASADORI
EUGEN WOLLFARTH, PËR TELEVISIONIN ORA NEWS**

29 dhjetor 2011

Gazetari: Mirëserdhët Z. Ambasador!

Ambasadori: Është një kënaqësi për mua të jem këtu.

Pyetje: Le të flasim për ato çështje për të cilat të gjithë janë të interesuar të dëgjojnë rekomandimet tuaja si Ambasador i Prezencës së OSBE-së. Ka qenë një vit politik i vështirë për të tërë shqiptarët. Do të dëshiroja të dëgjoja mendimet tuaja mbi vitin 2011 duke qenë se ju keni qenë i zënë për të bërë situatën politike të funksionojë më mirë dhe që Shqipëria të përmbushë ato reforma që janë pjesë e rekomandimeve të OSBE-së.

Përgjigje: Viti 2011 ishte vërtetë një vit interesant. Gjëja më e rëndësishme që duhet mbajtur mend është fryma konstruktive, ndërtimi i Shqipërisë, forcimi i saj për të ardhmen dhe tashmë janë bërë hapa gjigantë në këtë drejtim. Unë pata përshtypjen se së bashku me disa partnerë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, SHBA, dhe Bashkimi Evropian, siguruan një ndihmë të madhe për të arritur tek ky nivel fryme konstruktive. Unë jam thellësisht i bindur se është shumë e rëndësishme të ndihmojmë partnerët tonë Shqiptarë të mbajnë mend këtë. Ka të bëjë me ndërtimin për të ardhmen dhe me arritjen e integritimit Evropian. Kjo është një detyrë shumë e vështirë. Ka shumë për të zhvilluar, shumë për tu ndërtuar, jo vetëm në infrastrukturë por gjithashtu brenda qenieve njerëzore, në arsimim, dhe veçanërisht sjelljet e njerëzve. Këtu unë qëllimisht përfshij kuptimin e sistemit politik dhe demokratik. Kjo ka të bëjë me vlerat thelbësore të OSBE-së dhe me gjetjen e terreneve dhe vlerave të përbashkëta që janë demokratike dhe të orientuara drejt të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor. Dhe nëse kjo paketë e përbashkët arrihet, atëherë ky është rezultati më i mirë për ekonominë, për investime, dhe për vende pune. Kjo është e rëndësishme: të ardhura të sigurta në një ambient të sigurt. Unë mendoj se disa hapa përpara u hodhën në vitin 2011. Pati disa kthesa të rrezikshme. Nisi mjaft ashpër në fillim të vitit. Fatmirësisht nuk vazhdoi ashtu. Ne pamë zgjedhjet vendore, që ishin shumë të rëndësishme, me pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve dhe me disa vështirësi në procesin e numërimit të cilat kanë nevojë për rishikim. Ja përse nevojitet aq shumë një reformë zgjedhore. Pra, ka disa pika ku nevojitet të behet shumë punë, disa të tjera ku duhet bërë pak punë, por ajo që është e sigurt është se viti 2012 është përpara.

Pyetje: Z. Ambasador, a mendoni se zgjedhjet e 8 Majit ishin një test që u kalua me sukses, duke pasur parasysh të tëra problemet që ndeshët? Edhe pse ju keni shprehur mendimin në raportin tuaj, çfarë mendoni për to rreth 6 muaj me vonë? A mendoni se Shqiptarët e kaluan këtë test?

Përgjigje: Të tërë, nga brenda dhe jashtë Shqipërisë, kanë parë raportin e OSBE/ODIHR-it mbi zgjedhjet vendore. Ishte një hap. Nevojitet punë e mëtejshme. Kryetarët e bashkive janë zgjedhur dhe këshillat bashkiak janë formuar, dhe këta persona gjithashtu panë se çfarë duhet bërë për të parë përparim dhe për të gjetur mënyra më të mira për të organizuar gjërat. Sigurisht, pati disa vështirësi në emërimin e komisionerëve zgjedhor. Sidoqoftë, vetë dita e zgjedhjeve kaloi relativisht qetë, ndërsa procesi i numërimit pati qartësisht disa sfida në fusha të caktuara. Ai zgjati më shumë se pritej apo nevojitej – si për shembull në rastin e rezultatit për Tiranën. E gjithë kjo hapi disa diskutime për të ardhmen. Pra, çfarë duhet bërë në të ardhmen në mënyrë që Kodi Zgjedhor t'u japë përgjigje këtyre pyetjeve, si për shembull çështjes së votave të hedhura në rutinë e gabuar. Këto pyetje duhet të gjejnë përgjigje në

procesin e reformës duke pasur një fushë të barabartë për tërë pjesëmarrësit. Unë mendoj se është e rëndësishme gjithashtu të krijohet diçka që është thelbësore në tërë shoqëritë demokratike; besimi, besimi i ndërsjellët dhe gjithashtu besimi tek sistemi. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pati një detyrë shumë të vështirë në një klimë jo dhe aq dashamirëse, të organizonte zgjedhje që ishin teknikisht shumë komplekse në 384 njësi vendore. Pra, ishte një problem që duhej zgjidhur në një ditë dhe që pati gjithashtu disa pengesa dhe disa zgjedhje të përsëritura më vonë. Dhe nëse ajo mund të organizohet, dhe dua ta nënvizoj atë fjalë – nivel teknik – mund të shkojë më qetësisht kur kodi i ardhshëm zgjedhor ta trajtojë, atëherë do të jetë shumë më mirë. Ka gjithashtu lajme të mira që duhen nënvizuar. Viti 2011 pa krijimin e Komisionit Parlamentar Ad Hoc për rishikimin e Kodit Zgjedhor bazuar në udhëzimet dhe rekomandimet e raportuara nga OSBE/ODHIR-i nga zgjedhjet e viteve 2009 dhe 2011. Komisioni i Venecias ka dhënë gjithashtu këshillat e veta dhe ky është një plan pune i mirë. Ne gjithashtu ofruam ndihmën tonë dhe po presim të shikojmë rezultatet në fillim të vitit tjetër.

Pyetje: Z. Ambasador. Ju thatë që besimi i ndërsjellët ndërmjet palëve është shumë i rëndësishëm, gjithashtu besimi tek institucionet dhe më konkretisht KQZ-ja dhe institucione të tjera që trajtojnë zgjedhjet. Përse mendoni se ka mungesë besimi në politikën Shqiptare?

Përgjigje: Unë nuk jam psikoanalist. Le të kthehemi prapa. Nën regjimin e Enver Hoxhës, Shqipëria ishte duke kryer vetëshkatërrim. Si pasojë, mosbesimi tek sistemi dhe mosbesimi i ndërsjellët ishte i madh. Nuk i vë faj askujt që ka jetuar gjatë sistemit komunist duke mos besuar tek sistemi sepse ky i fundit bazohet tek abuzimi; abuzim ndaj vetë shoqërisë duke pretenduar se po bëhet diçka për njerëzit. Kjo është, Shqiptarët në fillim mendojnë se janë mashtruar nga personi në anën tjetër. Duhet të jetë e kundërta. Shqiptarët duhet të punojnë bashkë, duhet të ndërtojnë dhe të ndërmarrin çdo hap për të rifituar atë besim. Të ndërtosh besim nuk është e lehtë. Për këtë janë këtu OSBE-ja dhe partnerët e tjerë. Kjo është pjesë e emrit tonë, për të punuar së bashku, për të njohur e njëri-tjetrin në një nivel të ndërsjellët, për të parë se çfarë nevojitet për të ndihmuar në ndërtimin e një vendi dhe të një shoqërie së bashku. Të mësuarit mund të bëhet vetëm në mënyrë të përbashkët, dhe pastaj ndërtohet besimi. Kjo duhet bërë dhe pjesë të saj e kemi parë gjithashtu gjatë procesit të numërimit në tavolina që përfshijnë përfaqësues nga parti të ndryshme. Ne e shohim tani si dhe në punën e komisioneve parlamentare. Ne patjetër që e shohim në shoqërinë civile kur njerëz me mendime të ndryshme punojnë së bashku dhe gjejnë zgjidhje të përbashkëta. Unë do ta përshkruaja këtë si përparim i vërtetë. Në këtë kontekst, besimi ndërtohet nga poshtë, por patjetër që ka nevojë për kohë.

Pyetje: Duke vënë re se gjatë muajve të fundit politika Shqiptare i është afruar disi asaj që po thoni ju. A mendoni se bashkëpunimi që po bëhet ndërmjet partive politike për Kodin Zgjedhor dhe reformën zgjedhore është një bashkëpunim i sinqertë apo mendoni se është një bashkëpunim i imponuar?

Përgjigje: Do të thoja se është i sinqertë. Shumë njerëzve i pëlqen të marrin orientim, orientim nga drejtuesit e tyre, dhe kjo është thjeshtë njerëzore. Është absolutisht normale. Po, unë mendoj se është i sinqertë. Fola shkurtimisht më parë për vendet e punës. Çfarë përfitoni me integrimin në strukturat Evropiane? Përfitoni një shoqëri të bazuar në shtetin ligjor dhe siç kuptohet vetë në të drejtat e njeriut. Me shtetin ligjor ju do të kishit ndërmarrje më të mira dhe shpresojmë të suksesshme që do ofronin vende pune. Një ambient i kontrolluar nga shoqëria, që shpresojmë të ofrojë vende të shumta të sigurta pune për një numër të madh qytetarësh dhe, si pasojë, të gjenerojë krijimin e pasurisë për popullatën e gjerë. Kjo lidhet me krijimin dhe mikpritjen e lirisë individuale. Lidhet të paktën me të pasurit e një niveli të

përshatshëm të ardhurash për të shijuar jetën, për të pasur mundësinë për të paguar për shëndetësinë, për të paguar për arsimimin e vetes apo fëmijëve. Këto janë gjërat e rëndësishme në jetën e njeriut. Kjo është një detyrë komplekse dhe shumë hapa janë ndërmarrë në vitin 2011. Sidoqoftë, më shumë duhet të bëhet në vitet në vazhdim! Viti 2012, i cili do të jetë një vit shumë i veçantë për të tërë Shqiptarët për arsye të njëqind vjetorit të pavarësisë, do të jetë një vit i vështirë sepse detyra për tu kryer do të bëhet çdo ditë pak më komplekse. Dhe kjo duhet bërë si popull, si një popull duke identifikuar bazat e përbashkëta për tu bashkuar, për të ndërtuar diçka. Dhe pastaj vjen koha e konkurrimit në zgjedhje, për shembull për të prezantuar modele se si të vazhdohet nga pika ku ndodhemi dhe ku të hidhen hapat e radhës. Thelbi duhet të jetë i qartë: duhet të respektohen të drejtat e njeriut, shteti ligjor dhe demokracia dhe pastaj unë shoh perspektivat më të mira për të ardhmen e Shqipërisë.

Pyetje: Ju thatë që mezi po prisnit rezultatet e komisionit parlamentar ad hoc për reformën zgjedhore. Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëjmë ne që të kemi një Kod Zgjedhor të qartë dhe të kemi gjithçka gati përpara se të kalojë afati i vendosur nga partitë politike?

Përgjigje: Nuk është dhe aq e ndryshme nga reformat e tjera që nevojiten por është një reformë shumë e veçantë sepse ka të bëjë me ditën e parë të politikanëve – zgjedhjet. Për politikanët, të jesh kandidat mbase është koha më stresuese e jetës së tyre. Ata konkurrojnë, duan të zgjidhen dhe mezi presin të zgjidhen. Vullneti politik nevojitet jo vetëm për të fituar por gjithashtu është tepër i rëndësishëm dhe për një lojë të pastër. Kjo ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Kjo është arsyeja pse deklarohet vazhdimisht nga raportet e OSBE/ODIHR-it. Rekomandimi i parë në raportin e vitit 2009 ishte krijimi i një vullneti më të madh politik. Në vitin 2011, ishte pikërisht e njëjta gjë. Pra mundohuni të luani pastër, prisni lojë të pastër dhe gjëja e rëndësishme është media dhe publiku, publiku i interesuar. Ata kanë një rol të madh në të. Më kujtohet që klima në dhomë ishte mbresëlënëse dhe unë akoma admiroj njerëzit që numëruan, se si e bënë këtë nën rrethanat ekzistuese, me kamera, me ato makinat lexuese, me njerëz që numëronin publikisht, dhe duke bërë titur ndonjëherë. Dua të them se papritur kishte një interes shumë të madh mbi atë çka po ndodhte dhe një gjë e tillë nevojitet. Me këtë ushqehet demokracia. Ata ishin momente fantastike demokracie. Mua nuk më pëlqyen të tëra aspektet e procesit të numërimit. Disa nga numëruesit erdhën shumë vonë dhe pa dhënë ndonjë shpjegim të arsyeshëm. Kjo pjesë e procesit duhet të organizohet më mirë në të ardhmen, duke respektuar rregullat në mënyrë të përpiktë. Shumica e rregullave janë të mira, janë ligje të mira dhe rregullore të mira. Se si jetësohen ata dhe se si zbatohen, kjo është një pyetje tjetër dhe fatkeqësisht shumë shpesh përgjigja nuk është dhe aq pozitive.

Pyetje: Meqë përmendët çështjen e numëruesve, a është e mundur që zgjidhja më e mirë të jetë prezantimi i numërimit elektronik të votave?

Përgjigje: Kjo është për tu parë. Ka disa rreziqe me numërimin elektronik. Nevojitet gjithashtu shumë investim dhe përvojë. Unë jam nga një rajon i Gjermanisë i cili beson më shumë tek tradita. Ne përdorim letër shumë të lirë, si letër gazete, për fletët e votimit. Nuk janë aq të zhvilluara sa ato që përdorët këtu gjatë zgjedhjeve vendore. Ka të bëjë me kontrollin e ndërsjellët, anëtarë të partive të ndryshme politike që punojnë së bashku, numërojnë së bashku dhe mbikëqyrin procesin, procesin e votimit dhe procesin e numërimit së bashku, në mënyrë që mashtrimi të jetë gati i pamundur. Le të ndërtojmë atë besim që unë dua të përmend vazhdimisht. Provoni me pak besim, ndërtoni mbi të, dhe besimi rritet, dhe gjërat mund të bëhen më të qarta. Sa për votimin elektronik, disa shtete kanë përvoja të mira

me të, pra kjo gjë duhet parë. Por siç thashë, unë besoj më shumë tek mënyra tradicionale: kur njerëzit kanë qëllim të punojnë së bashku dhe të luajnë pastër, ata mund ta bëjnë.

Pyetje: Komisionit parlamentar ad hoc për reformën zgjedhore i është shtruar një çështje që po mbështetet nga disa parti të vogla, disa aleatë të PD-së dhe disa të tjera aleatë të PS-së, në lidhje me shtimin e korrektimit kombëtar tek sistemi proporcional rajonal. Sipas mendimit tuaj, a është kjo një çështje që duhet diskutuar dhe rishikuar, dhe a mund të zgjidhet?

Përgjigje: Patjetër që kjo kërkon diskutim politik, mbase në një nivel shumë të lartë kur bëhet fjalë për sistemin zgjedhor. Nëse e kam kuptuar mirë, në këtë fazë, qëllimi i komisionit ad hoc duhet të jetë duke u përqendruar tek Kodi Zgjedhor, i cili përfaqëson një çështje teknike se si të nxirret një panoramë korrekte të asaj që duan votuesit gjatë ditës së votimit, si të nxirret kjo panoramë në mënyrë sa më korrekte, dhe duke qenë sa më afër të jetë e mundur me nivelin 100% të korrektesisë. Sa për sistemin zgjedhor, kjo është një çështje politike që ju zgjidhni dhe demokracia jep një diapazon të gjerë mundësish. Ju mund të bëni votim proporcional, Gjermania përdor këtë model, të tjerë, si Britania e Madhe kanë një sistem maxhoritar i cili nuk i jep shumë mundësi partive të vogla politike. Varet nga ajo që vendoset këtu. Ajo që është e rëndësishme është të mos këtë të papritura apo ndryshime të shpejta apo shumë të shpeshta. Ndryshimet e fundit u ndërmorën në vitin 2008. Tani jemi në vitin 2011 dhe zgjedhjet e tjera do mbahen në vitin 2013. Pra, nevojitet kujdes dhe të kërkohej një konsensus i gjerë kur vendoset të ndryshohet përsëri sistemi. Kjo pyetje duhet të gjeje përgjigje nga partitë Shqiptare, duke përfshirë drejtuesit e tyre, dhe jo nga këshilla ndërkombëtare sepse kjo e fundit mund vetëm të tregojë se cilat modele ekzistojnë në botë. Diapazoni i modeleve është shumë i gjerë dhe e gjithë kjo mund të konsiderohet sipas rregullave demokratike si plotësisht në shërbim të demokracisë.

Pyetje: Është një çështje tjetër që do doja të ndaja me ju Z. Ambasador: disa parti të vogla politike po kërkojnë lista hapura kandidatësh. Cili është mendimi juaj për këtë çështje?

Përgjigje: Kjo është një çështje tjetër që ja vlen të diskutohet. Së pari, demokracia lejon përdorimin e listave të mbyllura apo të hapura. Nevojitet shumë kuptim dhe përfshirje gjithashtu nga qytetarët në mënyrë që vërtetë të përfitohet nga listat e hapura. Ata duhet vërtetë të kushtojnë kohë për mënyrën e zgjedhjes së kandidatëve. Nevojitet një shoqëri civile shumë të arsimuar, votues që kushtojnë shumë kohë, pra varet nga si vendoset. Përdorimi i listave të mbyllura nuk do të thotë se janë më pak demokratike se listat e hapura. Përdorimi i listave të hapura nuk do të thotë se zgjidhen të tëra problemet. Në rastin e sistemit zgjedhor, unë do veproja me kujdes dhe do përpiqesha të mos nxitoja.

Pyetje: Çfarë do të thotë kjo: të vepruarit me kujdes. Më shumë diskutime, më shumë vëmendje ...

Përgjigje: Edhe nëse tani nuk ndodh asnjë ndryshim në këtë kuadër, zgjedhjet e ardhshme mund prapë të jenë plotësisht demokratike.

Pyetje: Le të kalojmë bisedën tonë përtej procesit zgjedhor. Në përgjithësi, ka qenë një vit ku pati mjaft diskutim për reformat dhe në disa raste reformat u bllokuan. Cili është mendimi juaj mbi sjelljen e politikës Shqiptare gjatë këtij viti, dhe nuk e kam fjalën për njërin palë apo tjetrën, po flas për spektrin politik në përgjithësi?

Përgjigje: Sigurisht nuk ishte i mërzitshëm. Mua më pëlqeu më shumë pjesa e fundit. Le të kthehemi tek fryma konstruktive që nevojitet në vendimmarrje, për ndërtimin e terrenit të përbashkët, me Shqipërinë pjesë të një fshati, qyteze apo qyteti Evropian. Është shumë e

rëndësishme të identifkohet terreni i përbashkët duke filluar nga partitë politike. Gjithashtu, konsensusi është jashtëzakonisht i rëndësishëm kur bëhet fjalë për integrim Evropian, veçanërisht për tu marrë me Bashkimin Evropian sepse atëherë vendi duhet të jetë në një pozicion ku të jetë i aftë të zhvillojë dhe të prodhojë atë çka kërkohet. Kjo do të ndodhë shumë shpesh, jo vetëm kur bëhen rregullime në baze konsensuale për të kërkuar të ashtuquajturën shumicë të cilësuar në parlament gjë që qartësisht kërkon që PD-ja dhe PS-ja të identifkohen se si duan të veprojnë, kjo është shumë e rëndësishme, dhe të bëhet praktikë për të qenë të aftë për të ofruar shërbime që kënaqin shoqërinë e gjerë. Kjo është një cilësi që do të jetë shumë e nevojshme në tërë hapat e ardhshëm për integrim. Jam thellësisht i bindur se palët e përfshira janë të afta të arrijnë këtë, ata po konkurrojnë akoma por ka akoma nevojë për praktikë të mëtejshme.

Pyetje: Z. Ambasador. Po e mbyllim këtë vit në mënyrën më të mirë. Por që tani, në fund të këtij viti, po diskutohet një çështje, mbase është një diskutim i parakohshëm por po ndodh. Ky diskutim lidhet me Presidentin e ri. Nga njëra anë, Partia Socialiste dhe aleatët e saj kërkojnë një President konsensual, kurse nga ana tjetër, Partia Demokratike ka deklaruar qartësisht se Presidenti do të propozohet nga maxhoranca. Gjithashtu, Presidenti aktual, Z. Topi, ka deklaruar se nuk do të konkurrojë për pozicionin e Presidentit. A mund të jepni një vlerësim të parakohshëm për këtë proces, Z. Ambasador?

Përgjigje: Kam shumë respekt për Presidentin Topi. Është gjë e mirë që ai e ka bërë të qartë se plani i tij personal nuk pengon gjetjen e një kandidati për zgjedhjen e Presidentit. Nuk është një zgjedhje parlamentare, është një proces votimi në Parlament, dhe ka ndryshim të madh midis të dyjave. Pra, nuk do shohim shumë fushatë. Kuptohet që do ketë dhe të tillë, dhe në fakt kanë filluar disa diskutime mbi faktin se kush mund të jetë kandidati. Do të shohim. Do të jetë shumë e rëndësishme. Mund të jetë dhe një President i propozuar nga maxhoranca dhe përsëri të jetë konsensual. Varet të paktën nga personaliteti i kandidatit. Ajo që nevojitet, dhe mendoj se Kushtetuta e thotë mjaft qartë, është një person që është i aftë të punojë mbi nivelin partiak dhe të japë udhëzime, një shembull moral dhe më shumë se kaq për vendin, duke qenë një njeri i respektuar si Kryetar i Shtetit. Kjo nuk është gjithmonë e lehtë sepse kur vjen koha për të thënë diçka, gjithashtu ekziston rreziku të kritikohesh kurdo nga kushdo. Pra, duhet të jetë dikush me personalitet të qëndrueshëm, me aftësi për të përballuar një situatë të tillë, me bindje të thellë tek vlerat të cilat dhe ne i përfaqësojmë si organizatë, shteti ligjor, demokracia dhe të drejtat e njeriut. Jam i sigurt se do të jetë e mundur të gjendet një person që mund ta bëjë këtë. Sa për vetë procesin, Kushtetuta është shumë e qartë. Raundet e para vendosen me shumicë të cilësuar. Por Kushtetuta jep zgjidhje dhe po nuk pati konsensus. Ekziston një limit dhe pastaj është shumica drejtuese që vendos, çka është plotësisht demokratike. Kështu që unë nuk kuptoj disa elementë të diskutimit të tanishëm. Duhet shpenzuar shumë energji për të zgjedhur vërtetë një kandidat të mirë që të jetë i aftë të përmbushë pritshmëritë. Të jesh Kryetar i Shtetit është diçka shumë e veçantë në planetin tonë dhe Shqipëria, patjetër, meriton një personalitet të klasit të parë që të jetë i aftë të bëjë punën.

Pyetje: Sidoqoftë, pas raundit të tretë, Kushtetuta e përjashton mundësinë e një Presidentit konsensual.

Përgjigje: Nuk e përjashton, por siguron një votim alternativ që përsëri përbën një vendim të shumicës. Kjo është demokratike dhe sipas rregullave. Shumë e thjeshtë.

Pyetje: Një proces shumë i rëndësishëm që ndoqët ju Z. Ambasador, ishte zgjedhja e Avokatit të Popullit, e cila ishte gjithashtu pjesë e konsensusit në politikën Shqiptare,

çka është kërkuar prej një kohe të gjatë. Ju e vlerësuat dhe konfirmuat mbështetjen tuaj dhe pas zgjedhjes në Parlament. A ju duket kjo një bazë e mirë ku po ndërtohet konsensusi, pavarësisht nga këndvështrimeve të ndryshme për personin që u zgjodh si Avokat i Popullit.

Përgjigje: Ishte diçka e shkëlqyer në shumë aspekte. Dëshiroj ta përdor këtë mundësi për të përgëzuar Z. Igli Totozani për propozimin dhe emërimin e tij. Do të kisha dëshiruar që propozimi i emrit të Avokatit të Popullit të kishte ardhur më herët. Ai post ka qenë bosh për një kohë të gjatë. Sidoqoftë, kjo është e kaluara. Pati një ofertë nga ana e maxhorancës, nga Kryeministri, që Partia Socialiste mund të zgjidhte kandidatën. Do të kisha dëshiruar që ata të kishin zgjedhur më parë. Mua më pëlqeu shumë oferta dhe fakti që Kryeministri po mbante fjalën e dhënë. Më pëlqeu gjithashtu që Partia Socialiste organizoi një seancë dëgjimore publike, me nivelin maksimal të transparencës për këtë proces të rëndësishëm. Transparenca e shkëlqyer u konfirmua dhe në Parlament. Kur lexova Kushtetutën, unë u befasova për mirë kur pashë që Zyra e Avokatit të Popullit renditej vërtetë lart. Jam shumë i lumtur për popullin Shqiptar që tani ata kanë një Avokat Populli. Patjetër që i jap atij urimet më të mira për një punë të shkëlqyer për popullin Shqiptar, ata e meritojnë. Ai patjetër që është në një pozitë nga ku mund të ndihmojë shtetin ligjor të funksionojë përditë e më mirë.

Pyetje: Viti i ri, 2012, fillon pas tre ditësh. Sipas jush, ku duhet të përqendrohet axhenda e vitit 2012, duke pasur parasysh se Shqipëria kërkon statusin e vendit kandidat për në BE.

Përgjigje: Pak a shumë po më pyesni se çfarë rekomandimesh do jepja për vitin tjetër. Unë do sugjeroja të punohet sa më fort të jetë e mundur. Situata e përgjithshme ekonomike nuk është jashtëzakonisht e favorshme, por përqendrimi aty duke mos bërë asgjë për zhvillimin social mund të çojë drejt një rezultati të gabuar. Arsimimi i shoqërisë nëpër shkolla, kopshte, dhe nivel universitar është diçka komplekse që duhet bërë për të arritur zhvillim në të ardhmen. Duhet gjithashtu shumë punë për të pastruar Shqipërinë. Nuk e kuptoj përse disa njerëz, dhe këtu nuk po flas për njerëzit e varfër por për qytetet, jetojnë në një ambient që duket si një landfill. Përse të mos pastrohet tani për të pasur një ambient më të shëndetshëm dhe të sigurt? Përse të derdhen vajra në natyrë? Përse të hidhen qese plastike nëpër rrugë dhe të digjen goma, apo të kryhen veprime të tjera të pamenduara, sepse pasojat shkojnë drejtpërdrejtë në mushkëritë e fëmijëve tanë dhe shkatërrojnë shëndetin tonë. Kjo sigurisht që nuk është një gjë e mirë dhe nuk kushton shumë të mos bësh këto gjëra të papërgjegjshme. Mund të bëhet shumë pa ndonjë kosto të madhe, duke filluar nga sonte, dhe duhet bërë një gjë e tillë. Një gjë tjetër është që ndërsa dëgjoni këshillat dashamirëse të komunitetit ndërkombëtar, përpiquni gjithmonë të veproni, të punoni, të punoni fort për veten tuaj. Gjëja më e mirë që mund të bëjnë shqiptarët për veten e tyre është të ndërtojnë një Shqipëri më të mirë. Instrumentet janë aty dhe është gjithashtu shumë e rëndësishme të shikohen me kujdes zyrtarët publik teksa punojnë në mënyrë profesionale dhe që të mos ketë hapësirë për korrupsion, duke parë se çfarë bëhet me paratë e taksapaguesve dhe nëse diçka nuk bëhet në mënyrë korrekte, duhet denoncuar. Gjithashtu duhen respektuar institucionet shtetërore. Kushdo – i cili nuk është kriminel – sheh çdo ditë shtetin në formën e punonjësve të policisë në rrugë, i respekton ata dhe respekton qytetarët e zakonshëm, për të ndërtuar atë besim. Besimi shkon shumë mirë me respektin e ndërsjellët. Përse të ndalosh makinën në mes të rrugës për të dërguar një SMS teksa krijohet trafik prapa? Janë këto gjëra të vogla që formojnë një shoqëri ku mund të jetohej – thjeshtë nevojitet një sjellje më e mirë dhe me respekt si dhe punë për të fituar jetesën. Kjo nuk vlen vetëm për vitin 2012 – por dhe për të ardhmen, për Shqipërinë.

Pyetje: Mbase ne merremi shumë me politikë dhe harrojmë politikat sociale të cilat janë të rëndësishme për tërë problemet që përmendët.

Përgjigje: Këto janë pyetje shumë komplekse sepse politika duhet të mbulojë çështjet sociale dhe disa gjëra të tjera që përmenda më parë; Shëndeti, pensioni, arsimiti, të tëra këto kanë nevojë për vëmendje dhe janë një pjesë shumë e rëndësishme e politikës sepse kushtojnë para, janë faktorë të rëndësishëm për një shtet, apo për buxhetet e qyteteve – për arsimimin, ndërtimi i shkollave nëpër qytete mbulohet, me sa di unë, nga qeverisja vendore. Pra ka shumë për tu bërë me paratë e taksapaguesve dhe një shtet mund ta përballojë këtë vetëm duke forcuar vëmendjen tek ekonomia. Është e rëndësishme të kesh një ambient të përshtatshëm për të zhvilluar ekonominë siç është gjithashtu e rëndësishme të mos rrezikohen sektorë të rëndësishëm si turizmi, për shembull, sepse turistët pëlqejnë të kenë një ambient të pastër dhe male të pastra, kështu që kur ecën atje, për shembull kur ecën nga Valbona në Theth, gjë që dua të bëj vitin tjetër, dhe gjen plehra përreth, kjo nuk është diçka e mirë. Pra, të tërë këto gjëra që kanë lidhje me zhvillimin social dhe që kërkojnë përkujdesje. Lajmi i mirë është se ka përparim, ka pasur mjaft përparim. Njerëzit tani janë më të ndërgjegjshëm. Dhe disa zyrtarë vendorë në disa qarqe të caktuara e kanë kuptuar këtë dhe madje kanë filluar të ndajnë plehrat e kështu me radhë. Kjo tregon se ka përparim dhe se nevojitet të shpërndahet nëpër qarqet e tjera. Mua më pëlqen të shoh përparim dhe të shoh tekta përhapet.

Pyetje: Nga aspekti personal – ju keni qenë mjaft aktiv për të vizituar vendin, siç përmendët Valbonën. Çfarë mendoni për Shqipërinë? E kam fjalën për natyrën dhe historinë e saj.

Përgjigje: Ka vetëm një fjalë: Fantastike.

Pyetje: Është fundi i vitit. Edhe pak do të festojmë Vitin e Ri dhe për Shqiptarët kjo është një traditë shumë e rëndësishme, mbase më e rëndësishme krahasuar me vendet e tjera. Çfarë do të uronit për Shqiptarët si dhe për televizionin Ora News, i cili për pak ditë mbush pesë vjeç.

Përgjigje: Nga pikëpamja profesionale si Ambasadori i OSBE-së, si Kryetari i Prezencës, unë uroj të shoh zhvillimin e mëtijshëm të klimës konstruktive në Parlament dhe të zgjidhet axhenda e reformës me anë të kontributit nga të tëra palët, nga të tëra partitë e përfaqësuar në parlament, plus shoqërinë civile nga jashtë tij, të ketë diskutim të hapur, zgjidhje të mirë me baza të përbashkëta të forta për integrimin Evropian. Dhe, duke folur përsëri në aspektin profesional, nëse mund të jemi pjesë për të ndihmuar të arrihet e tërë kjo, ne nuk do ishim vetëm krenarë por edhe të lumtur. Kjo është lista e urimeve të mia sepse axhenda e reformës është relativisht e gjerë dhe nuk më takon mua të flas për 12 prioritetet e Bashkimit Evropian. Megjithatë, ata janë mjaft të lidhura me vlerat e OSBE-së, vlerat të cilat duhet të mbrojmë dhe të ndihmojmë vendin t'i jetësojë sepse kjo është në interes të tërë shqiptarëve.

Pyetje: Po për televizionin Ora News?

Përgjigje: Ky është një stacion lajmesh shumë i rëndësishëm. Nuk është hera e parë që jam këtu. Televizionin Ora News siguron informacione, informacione faktike për qytetarët, duke luajtur në këtë mënyrë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në shpërndarjen në kohë të fakteve tek publiku i gjerë dhe unë i uroj televizionit Ora News një të ardhme të suksesshme dhe një kontribut konstruktiv në ndërtimin e Shqipërisë.

Gazetari: Z. Ambasador, faleminderit që erdhët sonte në televizionin Ora News. Ishte një kënaqësi që ju patëm këtu për të ndarë me ne dhe me shikuesit tonë mendimet e vlefshme për reformën dhe për begatinë e Shqipërisë në vitin 2012.

Ambasadori: Faleminderit shumë.

Gazetari: Të nderuar miq, mendoj se kemi marrë disa përgjigje të rëndësishme në këtë komunikim me Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Z. Eugen Wollfarth, i cili ka qenë një mik i nderuar i studios sonë këtë mbrëmje. Faleminderit që na ndoqët.